**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME**
**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/566

# Procesverbal nga dëgjimi publik me klubet sportive OJQ-të

E mërkurë, më 21 qershor 2023
Kohëzgjatja e takimit: 17:00
Vendi i takimit: Salla e Kuvendit

Pjesëmarrës në takim: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtori i Drejtorisë së Administratës së përgjithshme - Valon Januzi; Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik – Kastriot Shabani, Drejtorja e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport - Albana Fazliu.

Rendi i ditës:

1. **Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026**

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Adnan Ademi, i cili i ka përshëndetur të pranishmit dhe i ka falënderuar që kanë gjetur kohë që sot të jenë së bashku me ne në këtë dëgjim publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026. Më tutje z. Ademi tha që arsyeja se pse ne sot jemi këtu të flasim për buxhetin është mjaft e rëndësishme, pasi edhe klubet e sportit, qytetarët edhe OJQ-të duhet të jenë pjesë e buxhetit. Prandaj ne sot do t'i marrim kërkesat e juaja dhe do t'i fusim në buxhetin e vitit 2024, që ta bëjmë më të lehtë punën tuaj. Sot është dita e fundit që ne po mbajmë diskutim publik dhe kemi qenë në të gjitha fshatrat e komunës dhe i kemi marrë të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe në fund po marrim edhe kërkesat e juaja.

Kërkesat e klubeve Sportive dhe OJQ-ve:

- **Safet Syla, kryetari i klubit karatist "Vjosa"** :
  Të vlerësohen më shumë sportistët të cilët marrin medalje të arta dhe të shpërblehen.
  Subvencionet të ndahen më herët sa i përket kohës.
  Sektori për sport të jetë më aktiv, të bëjnë vizita më të shpeshta zyrtarët nga komuna si Kryetari, drejtorët, Kryesuesi që t'ju japin më shumë vullnet sportistëve.
  Tek salla ku ne i kryejmë stërvitjet është shumë e ngushtë, prandaj do të ishte mirë të bëhet një projekt për një sallë për artet marciale.
  Bizneset e komunës të investojnë më shumë së klubet sportive.
- **Arsim Imeri, përfaqësues i klubit hendbollistik "Vjosa" - vajzat:**
  Tek zhveshtoret në palestrën e qytetit të bëhen intervenime dhe të rritet numri i tyre.

Të rregullohet ndriqimi tek salla e qytetit pasi që ndriqimi i cili është për momentin më shumë po na dëmton sesa ndihmon.

- **Bekim Shahini, kryetar i FC Futsall "Vjosa":**
  Ndriqimi nuk funksionon, gjithashtu edhe gjatë sezonës së dimrit nxemjet nuk fuksionojnë dhe lojtarët nuk mund të zhvillojnë stërvitje në aso kushte.
- **Ramiz Smajli Klubi i Ciklizmit "Vjosa":**
  Subvencionet të ndahen sipas meritokracisë, në bazë të klubeve që kanë fitues më shumë.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti

**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME**

**Lista e pjesëmarrësve** Klubet sportive - OJQ-të

**Data:** 21.06.2023

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | ARSIM IMERI, KHF VJOSA | [signature] |
| 2 | SHBA, Guri i Atreajtë, Sami Janun | [signature] |
| 3 | LULZIM AHMETI, KH "VJOSA" SHTIME | [signature] |
| 4 | SHAQIR SHAQIRI, KHF "VJOSA" SHTIME | [signature] |
| 5 | Ramiz Smajli, KLUBI SIKLIZMIT VJOSA | [signature] |
| 6 | BESNIK BEHA, KVF. ARISHTINA-SHTIME | [signature] |
| 7 | BESNIK SHAQIRI, FC. FUTSAL. VJOSA | [signature] |
| 8 | | |
| 9 | | |
| 10 | | |
| 11 | | |
| 12 | | |
| 13 | | |
| 14 | | |
| 15 | | |
| 16 | | |